KËRKESË
Nr.3823, datë 22.6.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Vora By Pass" Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkese për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit arë dhe objekte.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP" do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit për tokën arë dhe për objektin është 7 756 953 (shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
Drejtoria e Shpronësimeve

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I MBIKALIMIT TË VORËS

Nr.	**Pronari**						**Lloji i pasurisë**	**Çmimi**	**Vlera**	**Shënime**
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona	Nr.pas	Sip.m^2				
1.	Hasime	Bajram	Lamaj	2726	89/77	1543	arë	566	873338	Konf. nga ZRPP
2.	"Al Rexhina" Sh.p.k.			2726	89/76	1461	arë	566	826926	Konf. nga ZRPP
3.	Sulejman	Ali	Muça	2726	89/51	853	arë	566	482798	Konf. nga ZRPP
4.	Muharrem	Ali	Muça	2726	89/52	1168	arë	566	661088	Konf. nga ZRPP
5.	Sami	Osman	Muça	2726	89/110	1478	arë	566	836548	Konf. nga ZRPP
6.	Bujar	Osman	Muça	2726	89/111	553	arë	566	312998	Konf. nga ZRPP
7.	Shaban	Osman	Muça	2726	89/112	1124	arë	566	636184	Konf. nga ZRPP
8.	Nazmi	Osman	Muça	2726	89/113	1018	arë	566	576188	Konf. nga ZRPP
9.	Muharrem	Ali	Muça	2726	89/114	394	arë	566	223004	Konf. nga ZRPP
10.	Sylejman	Ali	Muça	2726	89/115	127	arë	566	71882	Konf. nga ZRPP
11.	B/pronarë		Muça	2726	89/18	343	arë	566	194138	Konf. nga ZRPP
12.	Ilmi		Haxhiu	2726			objekt		2061861	Konf. nga ZRPP
	Shuma					**10062**			**7756953**	Konf. nga ZRPP